



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 472 Prot.

Tiranë, më 14.07.2022

**VENDIM**  
**Nr.97, datë 14.07.2022**

**PËR**  
**PEZULLIMIN E PROCESIT TË NDJEKJES SË ZBATIMIT TË VENDIMEVE**  
**PARALAJMËRUESE TË KOMISIONERIT, PËR SHKAK TË PROCESIT TË**  
**RISTRUKTURIMIT TË INSTITUCIONIT, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E**  
**DOGANAVE.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me pezullimin e procesit të ndjekjes së zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, për shkak të procesit të ristrukturimit të institucionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,

**KONSTATOVA SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, janë regjistruar një sërë kërkesash nga nëpunës civilë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në të cilat kanë ngritur pretendimet se janë shkelur rregullat e administrimit të shërbimit civil, duke iu mohuar të drejtat që garanton ligji për qëndrueshmërinë në detyrë dhe vazhdimësinë në shërbimin civil.

Për verifikimin e informacioneve, bazuar në nenin 16, kreu III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer hetim i plotë administrativ i këtyre rasteve.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioneri është shprehur me vendime paralajmëruese, ku janë lënë detyra konkrete për rikthimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil për këto raste, duke i caktuar një afat konkret për kryerjen e veprimeve administrative, me kalimin e të cilit duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e vendimeve si më poshtë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 82, datë 22.07.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 85, datë 22.07.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 110, datë 05.10.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 114, datë 13.10.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 8, datë 11.01.2021, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr.42, datë 16.04.2021, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
7. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 68, datë 10.06.2021, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
8. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 2, datë 14.01.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
9. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 17, datë 03.02.2022, për nëpunësen \*\*\*\*\**);
10. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 34, datë 09.03.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
11. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 35, datë 10.03.2022, për nëpunësen \*\*\*\*\**);
12. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 37, datë 10.03.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
13. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 36, datë 10.03.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
14. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 47, datë 05.04.2022, për nëpunësen \*\*\*\*\**);
15. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 59, datë 28.04.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
16. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 65, datë 10.05.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
17. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 77, datë 30.05.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
18. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 78, datë 30.05.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
19. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 87, datë 28.06.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**).

Megjithëse kanë kaluar afatet e përcaktuara në vendimet paralajmëruese, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk është vendosur në dijeni mbi veprimet e ndërmarra në përmbushje të detyrimit të vendosur në dispozitivin e këtyre vendimeve.

Në vijim, rezulton se në zbatim të nenit 36/3 të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresat nr. 146/8 prot, datë 15.11.2021; nr.472 prot, datë 23.05.2022 dhe nr. 293/5 prot, datë 30.05.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të parashtojë arsyet e mosrespektimit të afatit të vendosur në vendimet e sipërcituara dhe njëkohësisht, *brenda 10 ditëve*, të dërgohet informacion në lidhje me masat konkrete që janë marrë për zbatimin e tyre, me paralajmërimin e vendosjes së masave administrative, duke aplikuar gjobë për punonjësit përgjegjës, bazuar në pikën 2 të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 10520/3 prot, datë 06.06.2022, administruar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 472/1 prot, datë 07.06.2022, ka informuar se në zbatim të Vendimit nr. 355, datë 26.05.2022, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për Personelin e Administratës Doganore*”, i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 81/2022, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është në proces ristrukturimi. Përfundimi i procesit të ristrukturimit në zbatim të parashikimeve ligjore do të zgjidhë të gjitha rastet e referuara në vendimet e marra nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ndodhur në këto rrethana, me qëllim që zbatimi i Vendimeve Paralajmëruese të Komisionerit të mos ecë paralelisht dhe të mos krijohet mbivendosje në kushtet kur institucioni është në proces ristrukturimi (*proces i cili kalon përmes afateve dhe etapave procedurale, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe duke pasur parasysh pasojat që prodhon ky proces në drejtim të sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori apo përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit*), çka do të sillte eventualisht rritjen e kompleksitetit dhe vështirësinë e procesit, si dhe duke patur parasysh, në rastin konkret, veçantitë e shërbimit doganor, vlerësohet se, referuar pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, është e domosdoshme të pezullohet procesi i ndjekjes së zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese të Komisionerit deri në përfundim të procesit të ristrukturimit të institucionit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## VENDOSA:

1. Pezullimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese të Komisionerit deri në përfundim të procesit të ristrukturimit të institucionit, si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 82, datë 22.07.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 85, datë 22.07.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 110, datë 05.10.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 114, datë 13.10.2020, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 8, datë 11.01.2021, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr.42, datë 16.04.2021, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 68, datë 10.06.2021, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 2, datë 14.01.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 17, datë 03.02.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 34, datë 09.03.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 35, datë 10.03.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 37, datë 10.03.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 36, datë 10.03.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 47, datë 05.04.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 59, datë 28.04.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 65, datë 10.05.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 77, datë 30.05.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 78, datë 30.05.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (*Vendimi Paralajmërues nr. 87, datë 28.06.2022, për nëpunësin \*\*\*\*\**).

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ngarkohet me detyrimin e njoftimit të këtij vendimi nëpunësve të përcaktuar në pikën 1, të tij.
4. Institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, duhet të njoftojnë menjëherë Komisionerin për çdo veprim që do të kryejnë në përmbushje të detyrimeve ligjore, në kuadrin e procesit të ristrukturimit të institucionit, sa i përket nëpunësve të përcaktuar në pikën 1, të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**